



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 08, datë 16.10.2017

PËR

**MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:
“RIKUALIFIKIM NË ZONËN URBANE PRANË QENDRËS SË QYTETIT VLORË,
RESTAURIMI I MONUMENTEVE TË KULTURËS NË KËTË ZONË DHE
RIKONSTRUKSION I OBJEKTEVE TË TJERË EKZISTUES”, BASHKIA VLORË**

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative; neneve 14/1, pika 2, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të Bashkisë Vlorë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Rikualifikim në zonën urbane pranë qendrës së qytetit Vlorë, restaurimi i monumenteve të kulturës në këtë zonë dhe rikonstruksion i objekteve të tjerë ekzistues”, Bashkia Vlorë, me subjekt zhvillues Bashkinë Vlorë.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
3. Procedurat administrative/ligjore për objektin e përmendur në pikën 1 të këtij Vendimi, do të vijohen nga Bashkia Vlorë, sipas përcaktimeve dhe rregullave të parashikuara në dispozitat e Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në përputhje me marrëveshjen përkatëse për delegim kompetencash, bashkëlidhur këtij Vendimi.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Bashkia Vlorë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.


KRYETARI

EDI RAMA




MINISTËR I KULTURËS

MIRELA KUMBARO



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT



LEDIATOTA
